



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1705/6 prot.

Datë 28.06.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 763/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.06.2024, shqyrtoi kërkesën me:

**Objekt:**

Kërkesë për heqje dorë, nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër ankimi elektronik A/2024/4260, protokolluar me nr. 1705/2024 prot., më datë 26.04.2024, të paraqitur nga BOE “Sireta 2F” SHPK & ‘Lis Konstruksion’ SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-02040-04-19-2024, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Vehcan, faza e I-rë Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd” me fond limit 77600000.0 (shtatëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

**Ankimues:**

BOE “Sireta 2F” SHPK me NIPT K51501008J dhe “Lis Konstruksion” SHPK me NIPT K66613407H.  
Adresa: Lagjja “Babrru Fushë”, Komuna Paskuqan, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Librazhd  
Adresa: Sheshi “Gjorg Golemi”, Librazhd.

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I*****Vlerësimi paraprak***

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

**II*****Rrethanat e çështjes***

II.1. Në datën 22.04.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-02040-04-19-2024, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Vehcan, faza e I-rë, Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd” me fond limit 77600000.0 (shtatëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.

II.2. Në datën 09.05.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton, se në datën 14.06.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE SIRETA 2F Shpk dhe LIS KONSTRUKSION Shpk, 57,777,777 lekë pa Tvsh skualifikuar
2. OE BAJRAMI N. Shpk 61,052,488.62 lekë pa Tvsh skualifikuar
3. BOE BIBA-X Shpk dhe BONUS” Shpk 61,101,757 lekë pa Tvsh skualifikuar
4. OE L.T.E CONSTRUCTION Shpk 61,211,143.51 lekë pa Tvsh kualifikuar
5. OE BE-IS Shpk 64.687.335 leke pa Tvsh kualifikuar
6. BOE ASI-2A CO Shpk & 2ZKonstruksion Shpk 69,543,986.58 leke pa Tvsh skualifikuar
7. OE Vellezerit Hysa Shpk 75.398.295,75 leke pa Tvsh kualifikuar

II.4. Në datën 20.06.2024, autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim-Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 26.06.2024, BOE ‘SIRETA 2F’ SHPK dhe ‘LIS KONSTRUKSION’ SHPK”, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike protokolluar me nr. 1705 prot, datë 26.06.2024 dhe me nr. Ankimi elektronik A/2024/4260, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.6. Bazuar në nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1405/3 prot., datë 27.06.2024, ka publikuar arsyet e skualifikimit që “BOE ‘Sireta 2F’ SHPK & ‘Lis Konstruksion’ SHPK” kundërshton me anë të ankesës me nr. 1705/2024 prot., datë 26.06.2024 dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4260.

II.7. Me shkresën me nr. 60 prot., datë 27.06.2024, me lëndë “Kërkesë për tërheqje nga ankesa për procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Vehcan, faza I-rë Njësia administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd”, dërguar nëpërmjet Sistemit të Ankesave

Elektronike, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1705/2 prot., datë 27.06.2024, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë për tërheqjen nga ankesa, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Në kërkesën e mësipërme operatori ekonomik ankimues citon: *“Shoqëria ”SIRETA-2F”shpk e njohur si person juridik me vendim të gjykatës së Tiranës me nr. 32385 datë 05.11.2004 dhe e pajisur me NIPT K51501008J, me seli në lagjen Babrru Fushë, Njësia Administrative Paskuqan, Tiranë, e përfaqësuar nga administratori i saj, Fatime Pali, mbajtëse e mjetit të identifikimit kartë identeti me nr. Personal H55405107G, ka marre pjese ne proceduren e prokurimit te zhvilluar me Date 09/05/2024, me Autoritet Kontraktor Bashkia Librazhd, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës se fshatit Vehcan ,faza e I-re Njesia Administrative Hotolisht ,Bashkia Librazhd”dhe me fond limit: 77 600 000 (shtatedhete e shtate milion e gjashteqind mije ) leke pa tvsh Lidhur me kete procedure prokurimi ne si shoqeri per arsye objektive kerkojme te heqim dore nga ankimi per kete tender, dhe ne kete menyre kerkojme qe ankimi nga shoqeria jone te mos merret parasysht”.*

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me kërkesën e “BOE ‘Sireta 2F SHPK’ dhe ‘Lis Konstruksion’ SHPK” protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën nr. 1705/2 prot, datë 27.06.2024, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Vehcan, faza I-rë, Njësia administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar parashikimeve të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet, se *“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës. 2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”* dhe parashikimeve të nenit 105 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,* i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik ankimues ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar, në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Me paraqitjen e kërkesës për tërheqje, ndërpritet shqyrtimi i ankesës menjëherë. Për efekt të tarifës, ankesa konsiderohet si e mospranuar, dhe tarifa e ankesës nuk kthehet.,* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt - ankimin e tij, dhe si pasojë mosshqyrtimit të ankesës së tij nga KPP, lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues,

sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë vetë ankimuesi shpreh vullnetin e tij të lirë për t'u tërhequr nga ankesa, të cilën ligjvënësi e ka përcaktuar si një mjet ligjor për t'i ardhur në ndihmë operatorëve ekonomikë të cilëve u janë prekur ose mund t'i preken interesat nga vendimet e autoritetit kontraktor, dhe për sa kohë që ankimuesi nuk shfaq më interes për procedurën e prokurimit në bazë të kërkesës së bërë, atëherë ankesa e bërë prej tij e humbet qëllimin e saj si një mjet ligjor nëpërmjet të cilit operatorët ekonomikë mund të realizonin qëllimin e tyre, për t'u shpallur fitues një procedurë prokurimi. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik "BOE 'SIRETA 2F SHPK' dhe 'LIS KONSTRUKSION' SHPK" për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117, të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës nr. 1705 prot, datë 26.06.2024, për procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të përfundojë procedimin administrativ për ankesën e "BOE 'SIRETA 2F SHPK' dhe 'LIS KONSTRUKSION SHPK'" për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr. REF-02040-04-19-2024 me objekt "Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Vehcan ,faza e I-rë, Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd" me fond limit 77600000.0 (shtatëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Librazhd.
2. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga BOE SIRETA 2F SHPK' dhe 'LIS KONSTRUKSION SHPK'".
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

